



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR KOMITETIN SHTETËROR PËR KULTET

I. HYRJJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është përgatitur programi i transparencës i Komitetit Shtetëror për Kultet.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës KSHK-ja ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

KSHK-ja angazhohet të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së KSHK-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare: <http://kshk.gov.al/>. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për paraqitjen publike të tij, mënyrën e paraqitjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program. (Pika IV)*

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së KSHK -së janë:

1. “E drejta për informim”, është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Angazhimi i publikimit maksimal të të dhënave; KSHK-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë, informacioni që përcillet nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e KSHK-së dhe përkatësisht; VKM –ja Nr. 459, datë 23.09.1999, i ndryshuar,
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, KSHK-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit <http://kshk.gov.al/>, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

- Tekstet e plota të VKM –ve që lidhen me rolin dhe misionin e institucionit, të marrëveshjeve që janë ratifikuar mes Këshillit të Ministrave dhe Bashkësive Fetare, Ligjin dhe VKM -të mbi financimin e tyre.
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim.
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet, strukturat e pagave për nëpunësit dhe mënyrat e përzgjedhjes së tyre.
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, (kur ekzistojnë).
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara.
- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Autoritetit Publik.

IV. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, KSHK-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit <http://kshk.gov.al/>, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

V. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, duke përfshirë dhe KSHK-në, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

VI. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TW TRANSPARENCWS SË KSHK

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/ Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Punonjësi përgjegjës
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik	Neni 7/1/a/d	Struktura organizative: http://kshk.gov.al/kryetari/ http://kshk.gov.al/departamentet/	Pas botimit në fletoren zyrtare	Në faqen zyrtare, në rubrikën “Rreth nesh”	Specialist që mbulon edhe burimet njerëzore
Të dhënat për arsimin, kualifikimin dhe nivelin e pagave të punonjësve	Neni 7/1/a/d	http://kshk.gov.al/wp-content/uploads/2014/03/ORGANIGRAMA-KSHK.pdf	Pas emërimit të punonjësve	Në faqen zyrtare, në rubrikën “Rreth nesh”	Specialist që mbulon edhe burimet njerëzore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

Baza Ligjore, dokumente politikash institucionale, etj	Neni 7/1/b	Legjislacioni shqiptar mbi fenë, VKM të ndryshme mbi KSHK dhe financimin, Marrëveshje mes shtetit dhe bashkësive fetare, raporte vjetore	Pas botimit në fletoren zyrtare; pas miratimit të titullarit; etj.	Në faqen zyrtare, në rubrikën "Baza ligjore"	Specialist që mbulon aspektet juridike
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Koordinator i për të Drejtën e Informimit: Znj. Nertila Këllici, Adresa: Blv. Zogu I, Nd.9, H.4, Ap.7, 1016 Tiranë; Tel: +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al Orari i punës: e hënë – e enjte, ora 08:00-16:30, e premte, ora 08:00-14:00	Pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit	Në rubrikën "PT", zëri "KPDI"	KPDI
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të përzgjedhjes së punonjësve	Neni 7/1/d	Sipas VKM –ve në fuqi për funksionimin e KSHK –së http://kshk.gov.al/baza-ligjore-2/	Pas botimit në fletoren zyrtare	Në faqen zyrtare, në rubrikën "Baza ligjore"	Specialist që mbulon edhe burimet njerëzore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

Buxheti	Neni 7/1/e	Buxheti	Pas miratimit të buxhetit vjetor	Në rubrikën “PT” , zëri “Buxheti”	Specialisti i financës
Informacion për procedurat e prokurimit	Neni 7/1/ë	Regjistri i Prokurimeve	Pas dorëzimit të Regjistrit të Prokurimeve	Në rubrikën “PT” , zëri “Regjistri i Prokurimeve”	Specialisti i financës
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Tabelë për kërkesat dhe trajtimet e tyre	Pas miratimit të PT	Në rubrikën “PT”, zëri “Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve”	KPDI